



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 2.8.2024

Nr: 72

Ora: 16:00

URDHËR
PËR

**ZBATIMIN E DISA RREGULLAVE PËR PERSONAT E PRANISHËM NË
TERRITORIN E OBJEKTEVE ZGJEDHORE KU JANË VENDOSUR QENDRAT E
VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË,
TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “dh”, e 2, nenit 109 dhe nenit 110 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 11, datë 25.3.2021, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të Komisioneve të Qendrave të Votimit”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 12, datë 30.12.2020, “Për miratimin e rregullave të veprimtarisë së Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve”, me qëllim garantimin e rregullit përgjatë procesit të votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024,

URDHËROJ:

- Në qendrën e votimit dhe përreth saj mund të qëndrojnë vetëm:
 - Anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit,
 - Zgjedhësit në radhë për të votuar,
 - Vëzhguesit e akredituar,
 - Përfaqësuesit e akredituar të medias,
 - Punonjësit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), dhe
 - Anëtarët e Komisionit të Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ).
- Ndalimin e qëndrimit dhe/ose të grumbullimit në mjediset jashtë qendrës së votimit, në oborrin e ndërtesës, në hyrje të saj, në korridoret e brendshme të ndërtesës ku është/janë të vendosura qendrat e votimit dhe përreth tyre në një distancë rrethore me rreze më të vogël se 150 m, të personave të tjerë, përveç atyre të përcaktuar në pikën 1, të këtij urdhri.
- Zgjedhësi i cili shkon për të votuar, drejtohet për në hyrjen e qendrës së votimit, vendoset në radhë dhe pasi ka përfunduar procesin e votimit duhet të largohet menjëherë nga qendra e votimit si dhe nga ambientet e tjera të brendshme, apo nga oborri i godinës ku është vendosur qendra/qendrat e votimit.

Data: 2.8.2024 Nr: 72
Ora: 16:00



“Për zbatimin e disa rregullave për personat e pranishëm në territorin e objekteve zgjedhore ku janë vendosur qendrat e votimit, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”

4. KQV-ja merr vendim për pezullimin e votimit dhe njofton KZAZ-në dhe Policinë e Shtetit, në rastin kur verifikohet mosrespektimi i pikave 1, 2 dhe 3, të këtij urdhri.
5. Në rast se KQV-ja nuk merr vendim, anëtari apo sekretari i KQV-së, që konstaton këtë fakt, mban një procesverbal dhe njofton menjëherë KZAZ-në përkatëse, KQZ-në dhe Policinë e Shtetit.
6. Në rast se KZAZ-ja nuk merr vendim për të njoftuar Policinë e Shtetit, çdo anëtar apo sekretari i KZAZ-së, pasi ka konfirmuar informacionin, njofton menjëherë KQZ-në dhe organet e Policisë së Shtetit, nëpërmjet formularit për kërkimin e ndihmës së Policisë së Shtetit model KQZ-04-13, për të marrë masat e nevojshme për të larguar personat që nuk lejohen të qëndrojnë pranë ambienteve të qendrave të votimit, sikurse përcaktohet në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij urdhri, si dhe aktet nënligjore të KQZ-së.
7. Krahas sa përcaktohet më sipër në këtë urdhër, çdo anëtar i KQV-së, i KZAZ-së, vëzhgues apo zgjedhës, kur konstaton shkelje të këtij urdhri, apo të akteve të tjera ligjore apo nënligjore në lidhje me praninë e personave të paautorizuar në mjediset përreth qendrës së votimit, në oborrin e ndërtesës, në hyrje të saj, në korridoret e brendshme të ndërtesës ku është/janë të vendosura qendrat e votimit dhe përreth tyre në një distancë rrethore me rreze më të vogël se 150 m, njofton menjëherë KQZ-në nëpërmjet numrit të telefonit të vënë në dispozicion të administratës zgjedhore (aplikacioneve *Whatsapp* dhe *Telegram*) apo nëpërmjet aplikacionit KQZ.
8. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



MODEL KQZ-00-42

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ Nr:

KQV

Nr: QARKU: Datë: Ora:

PROCESVERBAL

PËR KËRKIMIN E NDIHMËS SË POLICISË SË SHTETIT PËR RIVENDOSJEN E RENDIT NË NDËRTESESË E QENDRËS SË VOTIMIT

Bazuar në nenin 109 e nenin 110, të ligjit nr.1 0019, datë 29. 12. 2008 **“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”**, të ndryshuar, në **QV nr. ____/ __**, **kërkoj ndërhyrjen e Policisë së Shtetit për largimin e personave që nuk janë zgjedhës në radhë/të autorizuar për shkak se:**

(përshkrim i situatës/incidentit që rrezikon rendin/zhvillimin e rregullt të votimit)

Ky procesverbal i njoftohet menjëherë Policisë së Shtetit, KZAZ-së dhe Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ngjarja evidentohet në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Firma
1			
2			
3			



MODEL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KËRKESË
PËR NJOFTIMIN E POLICISË SË SHTETIT PËR VENDOSJEN E
RENDIT NË AMBJENTET JASHTË NDËRTESES SË QENDRËS
SË VOTIMIT

KZAZ Nr:	
BASHKIA:	

KËRKESË	Nr:	
Datë:		Ora:

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. _____ është njoftuar nga anëtari i KQV-së nr. ____/____, z/zj. _____ se në ambjentet e jashtme të QV-së, janë të pranishëm persona të paautorizuar, dhe/ose që nuk kanë asnjë arsye për të qëndruar (votues), dhe/ose rrezikohet rendi dhe zhvillimi i rregullt i procesit të votimit:

KËRKOJ:

- Praninë e punonjësit të Policisë së Shtetit në QV-në nr. ____/____, me adresë _____ për largimin e personave të paautorizuar dhe/ose për të rivendosur rendin në ambjentet jashtë ndërtesës së QV-ve.
- Një kopje e kësaj kërkesë i dorëzohet Punonjësit të Policisë së Shtetit përpara hyrjes në Qendrën Votimit.
- Kjo kërkesë, data dhe ora e saj, i njoftohet menjëherë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Emër Mbiemër	Pozicioni	Firma

